

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Krimeve të Rënda- gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, Besarta Doli dhe Myfera Hoxha anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale kundër të akuzuarve N. P. nga fshati Sh. Komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 të KPK-së dhe të akuzuarit F. C. nga Prishtina, për shkak të veprës penale tentim vrasje në ndihmë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 dhe nenin 25 të KPK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Publike të Qarkut në Prizren PP. nr. 33/2010 të datës 21.09.2011, në shqyrtimet gjyqësore të mbajtuara më datë 26.01.2016 dhe 21.02.2017, në prezencën e prokurorit Agron Matjani, të dëmtuarit N. S., të akuzuarit N. P. dhe mbrojtësit të tij N. D. avokat në Gjakovë, të akuzuarit F. C. dhe mbrojtësit të tij P. P. avokat në Gjakovë me datë **23.02.2017** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N. P.** i biri i Sh. dhe D., e gjinisë S., date lindjes..., në fshatin Sh. Komuna Vushtri, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i shkukurëzuar, atë i një fëmije, i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **F. C.**, i biri i H. dhe F., e gjinisë S., data e lindjes..., në Prishtinë, ku edhe jeton në këngëtar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, atë i një fëmije, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 14.06.2012 deri me datë 29.06.2012.

I akuzuari N. .

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale, elementet e të cilës vepër së qëllimshme penale nuk janë realizua, në atë mënyrë që me datë 31.10.2009 në mbrëmje, për shkak të mosmarrëveshjes që më herët e ka pasur me të dëmtuarin N. S. lidhur me djalin e axhës së tij, hynë në dhomën e mysafirëve të dëmtuarit në fshatin X., shkrep me revole në drejtim të dëmtuarit N. i cili ishte duke pushuar në krevat, e cila predhë e shpon krevatin e pastaj përleshet me të dëmtuarin ku gjatë përleshjes revolja rrokulliset nën krevat dhe kur ndërhyjnë i akuzuari F. e kap për beli të dëmtuarin N. atëherë i akuzuari N. e merr revolen ku shkrep edhe një herë në drejtim të dëmtuarit N., me ç' rast predha e revoles rrëshqitazi ia prek pjesën e epërme të kokës e pastaj ndërhyjnë nëna, bashkëshortja dhe dy kunatat e të dëmtuarit të cilat disi i largojnë me forcë të akuzuarit dhe gjatë largimit i akuzuari N. edhe një herë shkrep me revole ku predha kalon nëpër këmbët e familjarëve të dëmtuarit.

- **me çka ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 të KPK-së.**

ËSHTË FAJTOR

Sepse në vend dhe kohë të njëjtë të përshkruar më afërsisht sikur se në pikën I-rë, të dispozitivit të aktakuzës duke larguar pengesat me dashje e ndihmon tjetrin të kryen veprën penale, në atë mënyrë që pasi shoku i tij-i akuzuari N. P. shkrep herën e parë me revole në drejtim të dëmtuarit N. S. dhe kur gjatë përleshjes e vëren të akuzuarin duke shkëmbyer goditje reciproke me të dëmtuarin dhe ishin të kacafytur, e kap për beli të dëmtuarin N. e largon, e pastaj i akuzuari N. e merr revolen nën krevat dhe shkrep përsëri në drejtim të dëmtuarit me ç'rast predha e të cilës rrëshqitazi ia prek pjesën e epërme të kokës.

- **me çka ka kryer veprën penale tentim vrasje në ndihmë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 dhe nenin 25 të KPK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 3, 11, 15 par. 2, 34, 38, 64, 65, 66, 67 par. 1 nën par 2, 73, 146 lidhur me nenin 20 dhe 146 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK-së, dhe nenit 391 të KPPK-së i :

G J Y K O N

Të akuzuarin **N. P.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve.

Të akuzuarin **F. C.** dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.06.2012 deri me datë 29.06.2012.

I dëmtuari **N. S.** për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **100,00 €** dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej **100,00 €**, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren me aktakuzën PP.nr. 33/2010 të datës 21.09.2011, ka akuzuar N. P. nga fshati Sh. Komuna Vushtrris, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 të KPK-së dhe të akuzuarin F. C. nga Prishtina, për shkak të veprës penale tentim vrasje në ndihmë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 dhe neni 25 të KPK-së.

Prokurori **A. M.** në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se ngel në tërësi pranë aktakuzës ndaj të akuzuarit N. P., për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 të KPK-së dhe ndaj të akuzuarit F. C., për shkak të veprës penale tentim vrasje në ndihmë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 dhe nenin 25 të KPK-së. Ka shtuar se është vërtetuar se ditën kritike me datë 31.10.2009 të akuzuarit së bashku me Z. K. kanë shkuar në fshatin X. Komuna Rahovec, pasi sipas të akuzuarit N. të dëmtuarit N. S. ja ka dhënë 5000,00 € borxh dhe pasi kanë arritur në X., kanë shkuar në një restorant e i akuzuari N. ka konsumuar alkool, ndërsa i akuzuari F. kafe, e pastaj së bashku që të tre me automjet kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit N.. Ka theksuar se i akuzuari N. ka pasur me veti një armë, ka hyr në shtëpi ka kërkuar të dëmtuarin i cili ka qenë brenda në shtëpi në dhomë dhe kur i akuzuari brenda në shtëpi i ka mëshuar derës me shqelm dhe menjëherë ka gjuajtur dhe nuk ka arritur ta qëllloi të dëmtuarin, ashtu që i dëmtuari e ka kapur për qafe e në atë moment të akuzuarit N. i ka

rënë arma nga dora dhe i njëjti ka kërkuar ndihmë nga i akuzuari F. C. i cili në atë moment ka hyr në dhomë e ka kapur të dëmtuari N. për beli e ka tërhequr prapa e i akuzuari N. e ka shfrytëzuar momentin e ka marrë armën dhe ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit N. të cilin e ka plagosur në pjesën e epërme të kokës. Ka shtuar se këtë gjendje faktike më së miri e ka dëshmuar i dëmtuari N. S. e po ashtu edhe i akuzuari F. C. e ka përshkuar ngjarjes se si ka ndodhur si dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve është vërtetuar se dy të akuzuarit ditën kritike kanë qenë te shtëpia e të dëmtuarit dhe para se të largohen nga shtëpia i akuzuari N. ka gjuajtur me armë e kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga ekspertiza e mjekut ligjor dr. C. M. nga e cila ekspertizë është vërtetuar se i dëmtuari N. S. ka pësuar lëndime të lehta trupore në pjesën e epërme të kokës dhe ky lëndim i është shkaktuar nga predha e armës së zjarrit. Ka shtuar se gjykatës i propozon që të akuzuarit ti shpall fajtor për veprat penale për të cilat akuzohen dhe të ju shqipton dënim sipas ligjit, mirëpo me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i ka propozuar që si rrethanë rënduese për të akuzuarit të ketë parasysh që të njëjtit me herët kanë qenë të dënuar si dhe ka propozuar që të akuzuarit të obligohen që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale.

I dëmtuari N. S. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se kërkon që të akuzuarit të dënohen, si dhe kërkon kompensim dëmi për veti dhe familjen, por nuk e dinë vlerën e dëmit, si dhe ka shtuar se i akuzuari N. P. më mirë është të kërkoj falje para gjykatës, e jo të i dërgoj njerëz te shtëpia për të ja falur e në gjykatë sillet sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. P., avokati N. D. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor janë administruar të gjitha provat e propozuara nga prokuroria si dhe në fund i akuzuari ka dhënë mbrojtjen e tij ku një mbrojtje e tillë është shumë kredibile, sepse ka mbështetje në shumë prova tjera që janë administruar si dhe në disa rrethana të natyrës objektive nga vendi i ngjarjes edhe pse nuk është bërë ndonjë shikim apo rikonstruim i vendit të ngjarjes, andaj i propozon gjykatës që mbrojtësit të akuzuarit ti falet besimi. Ka shtuar se nuk janë kontestuese shumë fakte nga aktakuza siç janë shoqërimi dhe njohja e mëparshme e të akuzuarit dhe të dëmtuarit, pastaj dhënia e të hollave hua të dëmtuarit për shërimin e djalit dhe shkuarja në shtëpinë e të dëmtuarit ditën kritike, si dhe përpjekjet e të akuzuarit për sigurimin e borxhit nga i dëmtuari, e të cilat fakte i ka potencuar edhe prokurori në fjalën e tij përfundimtare. Ka theksuar se nuk janë elementet qenësore të veprës penale apo kanë mbetur të pa qarta si nuk është vërtetuar fakti se e kujt ka qenë revolja dhe ky fakt për fat të keq nuk mund të vërtetohet nga deponimet e dëshmitarëve, pasi nuk përjashtohet mundësia që edhe i akuzuari, i dëmtuari apo familjarët e tij mund ta mohojnë realitetin lidhur me këtë fakt, sepse gjatë hetimit nuk është nxjerr asnjë provë me të cilën ka mund të vërtetohet se kush ka qenë pronari i armës, edhe pse në vendin e ngjarjes ka pasur prova të mjaftueshme që të vërtetohet kjo rrethanë pasi janë gjetur dy gëzhoja të armës dhe ato predha dikush i ka futur në karikator por me gjasë gjatë hetimeve kanë vërejtur se i pandehuri është recidivist për veprat penale të natyrave tjera dhe shumë lehtë kanë supozuar se arma ka qenë e të akuzuarit N.. Ka shtuar se është fakt se ka pasur shkrepje me armë por nuk ka prova të mjaftueshme se gjatë atyre shkrepjeve cili ka qenë motivi apo dashja nëse eventualisht ka pasur motiv apo dashje për privim nga jeta të dëmtuarit, pasi sipas mbrojtjes me asnjërin nga provat e administruara nuk është vërtetuar dashja e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, e këtë bindje të mbrojtjes e vërtetojnë shumë rrethana siç janë raportet e mira në mes të akuzuarit dhe dëmtuarit, pastaj sasia e të hollave që i dëmtuari i ka pasur borxh, në asnjë mënyrë nuk ka mundur të ta motivojnë të akuzuarin ta kryej vrasjen apo tentim vrasje. Ka shtuar se po qese i referohet shikohet vendi ku ka ndodhur ngjarja sikur të kishte dashje duke pasur parasysh largësinë dhe pozicionin e palëve në mes veti, ka pasur mundësi ta qëlloi kudo, e nuk ka pasur nevojë që i akuzuari ta thënë derën ashtu siç pretendohet por ka mundur në mënyrë të qetë ta hap derën pasi e ka ditur shtëpinë e të dëmtuarit dhe ta privon nga jeta të njëjtin, e jo ti

eksponohet një rreziku siç pretendon prokuroria. Ka shtuar se bazuar në të gjitha këto fakte dhe rrethana që i ka theksuar më lartë rezulton se i akuzuari të gjitha veprimet i ka marrë në një situatë të mbrojtjes nga vet i dëmtuari, pasi ka arritur që nga duart të ja merre revolen e këtë rrethanë e vërteton edhe deponimi i të pandehurit tjetër ku thotë se ka shtënë dy herë, e herën e parë ka shtënë në drejtim, e herën e dytë poshtë, e atëherë për çfarë arsye ka shtënë poshtë kur ka pasur mundësi që ta privoj nga jeta drejtpërdrejtë, ashtu që ka propozuar gjykatës që ndaj të akuzuarit të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari **N. P.** gjatë mbrojtjes së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 21.01.2016 duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar mbetet në tërësi në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 05.09.2011. Ka shtuar se të dëmtuarit N. ja ka dhënë 5000,00 € borxh për shkak se e ka pasur djalin e sëmur dhe të hollat ja ka dhënë në lokalin “P.” i cili gjendet në D. në Prishtinë, dhe këto të hollat kanë qenë arsye pse kanë ardhur deri te konflikti. Ka theksuar se para se të vije deri te ky konflikt djali i mixhës së të dëmtuarit, H. Th. e ka thirre me telefon nga burgu dhe i ka thënë a mundesh me shkua te N. me marrë bari-narkotik e me ja dërguar një shoku të tij në Prishtinë të cilit nuk ja dinë emrin, ka shkua te N. në fshatin X. e kanë marrë barin dhe janë nisur për Prishtinë dhe tek konviktet në Prishtinë i kanë arrestuar policia, e pasi N. ka filluar të qaj vet personalisht i ka thënë policisë se e ka blerë këtë drogë në Vushtri. Ka shtuar se ka qenë së bashku me F. C. dhe Z. K. kanë shkua në fshatin X. afërisht kah ora 11,00-12,00/h e ditës dhe gjatë asaj dite kanë shkua te shtëpia e të dëmtuari për ta kërkuar, e pasi nuk e kanë gjetur kanë ndenjur deri në mbrëmje e kur ka filluar të errësohet kanë shkua sërish te shtëpia e të dëmtuarit e ka parë automjetin e tij në oborr, i ka thënë një djali thirre N. e ai ka thënë nuk është këtu, e pasi vet i ka thënë po është këtu ka hyr në oborr së bashku me atë fëmiun i cili e thirre dhe i ka treguar të dëmtuarit se po të thirre N. e i dëmtuari i ka thënë thuaj se nuk është këtu, e këtë e ka dëgjuar nga dritarja e vet, i ka thënë dil o N. se po të dëgjoj, e pastaj ai ka thënë “hajde o bir hajde” pasi kështu e ka pasur shprehi ta thërret. Ka theksuar se ka hipur në ballkon te dera e korridorit është ndalur ka dal i dëmtuari e ka kap me të dy duart, e ka shajtur dhe e ka tërhequr brenda te dhoma e pritjes, e te dera e hyrjes së dhomës së pritjes vet i ka vendosur duart në të dy anët e derës dhe e ka parë kur i dëmtuari e ka zgjatur dorën te televizori për ta marrë revolen, e atëherë e ka kapur për dore të dëmtuarin ja ka hequr revolen dhe ka filluar ta godas të dëmtuarin me revole në kokë, ka kërcitur revolja e pastaj e ka gjuajtur revolen e i dëmtuari e ka kapur me dy duar për qafe, e duke ku rrokur në mes veti i kanë rrezuar të gjitha gjësendet e revolja ka mbetur në tokë te një qoshe të krevatit, i cili e ka pasur formën e germës “G” e pastaj pasi F. e ka dëgjuar revolen ka hyr brenda e si ka hyr F. brenda i dëmtuari e ka lëshuar, e atëherë vet e ka kapur sërish revolen e ka pyetur të dëmtuarin pse ma bërë kështu e ka gjuajtur edhe një herë afërsisht një metër afër krevatit në tokë, e pastaj kanë ardhur nëna, gruaja dhe kunata e tij e ku nëna i ka thënë o leje se ti japim paratë. Ka shtuar se menjëherë pasi kanë ardhur ato ka dal jashtë dhe i ka thënë nuk i vyen më ato para dhe te dera e oborrit kanë qene disa lule revoles ja ka hequr karikatorin e revolen e ka gjuajtur në lule, karikatorin e ka vendosur në xhep dhe gjatë rrugës e ka gjuajtur karikatorin nga makina. Ka shtuar se fisheku e ka goditur N. jo kur ka gjuajtur në tokë, por në momentin kur ka qenë duke e goditur me revole në kokë ku ka kërcitur revolja, pra herën e parë kur ka kërcitur revolja është goditur i dëmtuari. Ka theksuar se tërë ditën ka qenë në lokale nëpër X. nuk ka pasur armë me veti nuk ka mbajtur kurrë armë, bile atë ditë kah kanë shkua në X. në Malishevë i ka ndalur policia, nuk e dinë tipin e armës por ka qenë e bardhë, nuk e dinë sa fishek i kanë mbetur në karikator dhe pas këtij rasti nuk i ka kërkuar më të hollat nga i dëmtuari. Ka shtuar se ka hyr brenda në shtëpinë e të dëmtuarit pasi shpesh herë ka shkua në oborr por brenda nuk ka qenë kurrë si dhe kur ja ka dhënë të hollat hua në shumën prej 5000,00 € borxh ka qenë vetëm me të dëmtuarin, nuk ka dëshmitarë që ja ka dhënë të hollat nuk i kujtohet muaji kur ja ka dhënë të

hollat dhe ditën kritike ka konsumuar alkool. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të tij ka theksuar se para ditës kritike shumë herë i ka kërkuar të hollat nga N. i cili ka ardhur në Prishtinë dhe gjatë kësaj kohe deri sa ka ndodhur rasti janë shoqëruar në mes veti dhe ditën kritike ngjarja është zhvilluar në dhomë, ku dera e dhomës ka qenë e hapur dhe kur në dhomë kanë ardhur nëna dhe bashkëshortja e të dëmtuarit nuk ka pasur përlëshje dhe F. në dhomë ka hyr para se të vinë familjarët e të dëmtuarit, si dhe edhe kur kanë biseduar për drogën kanë qenë vetëm me të dëmtuarin N.. Ka shtuar se kur ka hyr në oborr i akuzuari F. ka qëndruar te dyert e oborrit dhe largësia nga shtëpia e deri te dyert e oborrit ka mund të jetë 25 metra dhe kur F. ka hyr në dhomë kanë qenë të ulur në kauç e ka qenë i kapur për qafe nga i dëmtuari dhe kur ka hyr F. brenda i dëmtuari N. ka qenë i lënduar dhe me revole ka gjuajtur dy herë. Ka theksuar se F. nuk e ka thirrë për të hyr brenda por ai ka shkuar vet dhe duke u përgjigjur në pyetjen se pse në shqyrtimin gjyqësor të datës 01.02.2012 keni dhënë se më duket kam thirrë o F. është përgjigjur nuk e din se ka qenë i ngulfatur nga i dëmtuari dhe nuk ka pasur mundësi që ta thërras. Ka shtuar se nuk e ka parë që i akuzuari Fadil e ka kapur për dore të dëmtuar për ta larguar sepse posa ka hyr F. brenda i dëmtuari është larguar dhe e ka lëshuar dhe duke u përgjigjur sërish në pyetjen se pse në shqyrtimin gjyqësor të datës 01.02.2012 keni thënë se F. e ka kapur për krahu të dëmtuarin ndërsa në prokurori keni thënë e ka kapur për dy duart të dëmtuarin është përgjigjur se nuk e ka parë që F. e ka kapur të dëmtuarin N. dhe nuk ka për dijeni se si ka kërcitur revolja deri sa ka qenë duke e goditur të dëmtuarin në kokë pasi herën e parë nuk e ka repetuar ndërsa herën e dytë e ka repetuar. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se i vije keq për këtë që ka ndodhur.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. C., avokati **P. P.** në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se duke bërë analizimin e secilës provë veç e veç e në lidhshmëri me njëra tjetrën rezulton se në veprimet e të akuzuarit F. C. nuk janë përmbushur elementet e veprës penale ndihmë të vrasjes në tentativë. Ka theksuar se prokurori ka dështuar ta vërtetoi se i akuzuari F. duke larguar pengesat me dashje e ka ndihmuar tjetrin ta kryej veprën penale të përshkuar si në aktakuzë, edhe pse e tërë intenca e prokurorisë mbështetet në momentin e kinse tërheqjes nga prapa nga ana e të akuzuarit të dëmtuarin N. çka nuk është vërtetuar nga deklaratat e vet të akuzuarit F., e cila pothuaj në tërësi mbështetet edhe nga i dëmtuari N. Ka shtuar se nga kjo rezulton se këtë nuk ka mund ta bëjë pa rrezikimin e jetës dhe shëndetit të vet të pandehurit andaj i vetmi propozim i mbrojtjes është që i akuzuari F. të lirohet nga akuza në mungesë të provave.

I akuzuari **F. C.** gjatë mbrojtjes së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 21.02.2017 duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori me datë 28.05.2010. Ka shtuar se te i dëmtuari kanë shkuar pasi i njëjti i ka pasur borxh N. 5500,00 € dhe në prokurori ka thënë 5000,00 €, pasi ndoshta ka harruar dhe me të akuzuarin N. ka shkuar pasi janë shok që 32 vite dhe në fshatin X. kanë shkuar pas dite dhe drejtpërdrejtë kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit. Ka shtuar se kur i akuzuari N. ka hyr brenda te shtëpia e të dëmtuarit vet ka qenë brenda në automjet me personin e quajtur Z. K. ni cili i ka sjellë me makinë dhe afërsisht pas pesë minutave pasi ka hyr N. brenda ka shkuar edhe vet pasi ka dëgjuar krismën e revoles. Ka shtuar se edhe më herët së bashku me N. kanë qenë mysafir në shtëpinë e të dëmtuarit dhe ka për dijeni se atyre dyve ju është zënë një paketë me drogë dhe kanë qenë të dënuar. Ka theksuar se pasi ishte afër e ka ditur se krisma e armës ndodhi te shtëpia e të dëmtuarit dhe kur ka hyr brenda ka parë që i dëmtuari e kishte kapur te akuzuarin N. për fyti, e kur ka hyr brenda i dëmtuari e ka pyetur çka ka o bir N. e vet i është përgjigjur qysh çka ka nuk ja ke larë paratë, e atëherë vet të dëmtuarin N. e ka kapur për beli dhe e ka larguar nga N. e revolja kishte pas rënë në dysheme të dhomës në largësi prej 3-4 metra e i akuzuari N. e ka kapur revolen dhe ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit N. dhe ai fishek e ka rrokur përshkitazi

në kokë. Ka shtuar se kur ka gjuajtur N. në drejtim të dëmtuarit ka qenë në largësi rreth një metër, ndërsa vet e ka pas lëshuar të dëmtuarin dhe ka qenë brenda në dhomë në këmbë dhe kur e ka kapur të dëmtuarin për beli për ta larguar, nuk i ka parë që i dëmtuari ka pasur gjak, si dhe kur N. ka gjuajtur në drejtim të N. ata kanë qenë ballë për ballë në largësi prej një metër. Ka theksuar se e ka marrë N. dhe janë larguar nga shtëpia pasi erdhën gruaja dhe fëmija e N. ka gjuajtur edhe një herë me revole në tokë dhe armën e ka gjuajtur duke dal nga shtëpia si dhe kur kanë hyr brenda në automjet N. nuk i ka parë ndonjë karikator të armës, si dhe në automjet ka qenë i ulur prapa N. përpara dhe nuk ka parë që N. e ka hapur xhamin dhe ka gjuajtur diçka nga automjeti, sepse do ta kishte vërejtur. Ka shtuar se kanë shkuar në Prishtinë ku Z. i ka lënë e ai ka shkuar në shtëpinë e vet dhe N. nuk i ka premtuar se nëse i marrin të hollat nga i dëmtuari do të jep edhe atij të holla. Ka shtuar se është e vërtetë se N. e ka thirrë o F. si dhe i ka parë gruan dhe fëmijët e të dëmtuarit dhe largësia nga automjeti deri te shtëpia ka qenë 5-6 metra dhe kur ka dëgjuar N. duke thirrë o F. ka qenë pas krismës. Ka theksuar se nuk i kujtohet se a i kanë pasur dritaret e automjetit të hapura apo të mbyllura dhe gjatë rrugës për në fshatin X. N. nuk i ka thënë asgjë se do të ndërmerre diçka nëse i dëmtuari N. nuk ja paguan borxhin dhe herën e dytë kur N. ka gjuajtur në të dëmtuarin vet ka qenë duke dalur nga dhoma në largësi 2-3 metra. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka shtuar se atë ditë të akuzuarit N. nuk i ka parë armë edhe pse i njëjti ka pasur të veshur vetëm një këmishë, nuk ka pasur qante dore me veti dhe të akuzuarin N. duke gjuajtur e ka parë dy herë, por tani thekson se sqaron se vet deri sa vet ka qenë jashtë shtëpisë nuk ka dëgjuar krismë vetëm ka dëgjuar kur ka thirrë o F. dhe i akuzuari N. ka gjuajtur në drejtim të N., si dhe ka theksuar se vet ka qenë i sëmur, pas një fatkeqësie ka pasur gjakderdhje në tru dhe pesë ditë ka qëndruar në spital ka qenë pa vetëdije. Ka theksuar se për borxhin që i dëmtuari ja ka pasur të akuzuarit N. i ka treguar vet i akuzuari.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e procedimit të provave, vlerësimit dhe analizimit të tyre një nga një, e pastaj në lidhje me njëra tjetrën, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari N. P. me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale, elementet e të cilës vepër së qëllimshme penale nuk janë realizua, në atë mënyrë që me datë 31.10.2009 në mbrëmje, për shkak të mosmarrëveshjes që më herët e ka pasur me të dëmtuarin N. S. lidhur me djalin e axhës së tij, hynë në dhomën e mysafirëve të dëmtuarit në fshatin X., shkrep me revole në drejtim të dëmtuarit N. i cili ishte duke pushuar në krevat, e cila predhë e shpon krevatin e pastaj përleshet me të dëmtuarin ku gjatë përleshjes revolva rrokulliset nën krevat dhe kur ndërhyjnë i akuzuari F. e kap për beli të dëmtuarin N. atëherë i akuzuari N. e merr revolen ku shkrep edhe një herë në drejtim të dëmtuarit N., me ç' rast predha e revoles rrëshqitazi ia prek pjesën e epërme të kokës e pastaj ndërhyjnë nëna, bashkëshortja dhe dy kunatat e të dëmtuarit të cilat disi i largojnë me forcë të akuzuarit dhe gjatë largimit i akuzuari N. edhe një herë shkrep me revole ku predha kalon nëpër këmbët e familjarëve të dëmtuarit.

Si dhe i akuzuari F. C. në vend dhe kohë të njëjtë të përshkruar më afërsisht sikur se në pikën I-rë, të dispozitivit të aktgjykimit duke larguar pengesat me dashje e ndihmon tjetrin të kryen veprën penale, në atë mënyrë që pasi shoku i tij-i akuzuari N. P. shkrep herën e parë me revole në drejtim të dëmtuarit N. S. dhe kur gjatë përleshjes e vëren të akuzuarin duke shkëmbyer goditje reciproke me të dëmtuarin e kap për beli të dëmtuarin N. e pastaj i akuzuari N. e merr revolen nën krevat dhe shkrep përsëri në drejtim të dëmtuarit, predha e të cilës rrëshqitazi ia prek pjesën e epërme të kokës.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dëshmia e të dëmtuarit N. S. e dhënë në cilësinë e dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 26.01.2017, dëshmia e mjekut ligjor dr. C. M. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 26.01.2017, dëshmia e dëshmitarëve Z. K., S. Th., L. Th. e dhënë gjatë shqyrtimit

gjqësor të datës 12.03.2012, raporti i repartit të emergjencës datës 30.10.2009 për të dëmtuarin N. S., mendimi i ekspertit mjeko ligjor lidhur me natyrën e lëndimeve trupore të dëmtuarit, lista e dëshmive së bashku me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe foto albumi i vendit të ngjarjes, si dhe pjesërisht edhe nga vet deklaratimet e të akuzuarve, e veçanërisht nga deklarimi i të akuzuarit F. C. të parashtruar gjatë mbrojtjes së tij.

I dëmtuari N. S. gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 26.01.2017, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka theksuar se është e vërtetë që ka dhënë deklaratë në prokurori me datë 20.08.2010 dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe se mbetet në tërësi pranë këtyre deklarimeve. Ka shtuar se me dy të akuzuarit është njohur në burgun e D., ku kanë qëndruar nga viti 2002 deri me vitin 2007, si dhe pas daljes nga burgu ka mbajtur kontakt me dy të akuzuarit dhe mosmarrëveshja me të akuzuarit ka qenë pasi është liruar nga burgu në vitin 2007, ka qenë viti 2008 kur së bashku me të akuzuari N. P. janë arrestuar nga policia e Prishtinës me një sasi të narkotikëve gjegjësisht në sasi prej 37 gram dhe për këtë vepër secili ka qenë i dënuar nga 8 (tetë) muaj dënim me burgim dhe pasi kanë vuajtur dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, thekson se narkotikun të cilin ja kanë zënë policia kanë pasur për qëllim për të ja dërguar djalit të mixhës së tij H. Th. në burgun e Dubravës. Ka shtuar se një ditë ka shkuar te shtëpia e të akuzuarit F. C., e ku ka qenë i pranishëm edhe i akuzuari N. dhe nga i akuzuari N. ka pasur shumë presion, pasi i njëjti vazhdimisht ka bërë presion për të ja lënë automjetin, me arsyetimin se e ka vuajtur burgun për shkak se ata kanë dashur të ja dërgojnë drogën djalit të mixhës në burg. Ka theksuar se automjeti ka qenë R., limuzinë me ngjyrë të bardhë dhe në atë kohë këtë automjet e ka blerë në shumën prej 5000,00 €, e kur nuk ka pranuar që të ja jep automjetin i akuzuari N. është acaruar, e atëherë vet ka pranuar që të ja jep të hollat vetëm e vetëm që të largohet nga shtëpia, por i akuzuar N. nuk e ka precizuar shumën e të hollave dhe pas këtij rasti nuk janë takuar fizikisht mirëpo kanë pasur 2-3 telefonata me të akuzuarin N., por i cili vazhdimisht ja ka kërkuar të hollat. Ka shtuar se natën kritike ka qenë në fshatin Ratkoc, i cili është në largësi nga fshati i tij afërsisht 90 km, dhe kur është kthyer në shtëpi fëmijët e vëllezërve të tij i kanë treguar se e ka kërkuar dikush 2-3 herë dhe pasi është kthyer në shtëpi nuk i kujtohet koha ka qenë natë, ka qenë e ndalur rryma, e ka pasur të ndezur qiri në dhomë ku pa prit një herë ka kërcitur dera e shtëpisë dhe deri sa vet ka qenë i shtrirë i akuzuari N. i ka mëshuar derës së dhomës me shkelmë dhe e ka repetuar revolen ka shtënë, e pasi ka shtënë i akuzuari N. e ka kapur janë përleshur në mes veti bile aty e ka thyer ormanin, televizionin dhe të gjitha sendet që ishin në dhomë dhe dhoma ishte e tillë ku dritarja ka qenë në mes të dy krevateve dhe ka arritur që ta rrëzoi të akuzuarin N., e revolja ka rënë te dritarja e deri sa vet ka qenë mbi të akuzuarin që të dy kanë bërë përpjekje ta marrin revolen në atë moment i akuzuari ka bërtitur o F. dhe pas 5-10 sekondave ka hyr i akuzuari F. i cili kishte qenë në ballkon të shtëpisë e ka kapur për beli e ka larguar nga i akuzuarin N. të cilin e kishte përfund e atëherë i akuzuari N. ka marrë revolen ka shtënë sërish e në atë rast plumbi e ka goditur në kokë dhe ja ka prekur lëkurën e kokës. Ka shtuar se i akuzuari kur ka gjuajtur me revole ka qenë në largësi ndoshta 1-2 metra dhe menjëherë ka ardhur bashkëshortja dhe nëna e tij janë takuar me dy të akuzuarit e i akuzuari N. edhe një herë ka shtënë në afërsi të këmbës së nënës së tij ku fisheku ka goditur frigoriferin, e pastaj ka ardhur edhe babai e ku e kemi lajmëruar rastin në polici, ndërsa vet ka shkuar në emergjencën e spitalit në Gjakovë. Ka theksuar se i kujtohet që pas këtij rasti ka biseduar në telefon me të akuzuarin N. një apo dy herë i cili i ka kërkuar falje dhe i ka thënë se ka qenë nën ndikimin e alkoolit dhe nuk e din as vet se çka ka bërë, ka biseduar edhe me Z. K. i cili atë natë ka qenë shofer edhe ai ka kërkuar falje dhe të njëjtin e njeh pasi ka ndejtur në burg me te. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka theksuar se ideja për ta dërguar drogën në burg ka qenë e të akuzuarit N., pasi i akuzuari N. ka folur me H. në burg e kur ka ardhur në fshatin X. vet ja ka siguruar drogën dhe për këtë fakt është deklaruar

në prokurori në Prizren. Ka theksuar se në atë kohë ka pasur një djalë dhe gjatë kohës sa ka qenë në burgun e Dubravës djali ka qenë i sëmur dhe duke u shëruar në spitalin e Gjakovës dhe pasi ka dal nga burgu është marrë me shitblerjen e pemëve dhe perimeve në fshatin X.. Ka shtuar se me të akuzuarin N. i ka pasur raportet e mira dhe i njëjti shumë herë ka qenë në shtëpinë e tij ka ngrënë bukë por edhe vet ka qenë te shtëpia e të akuzuarit. Shton se natën kritike ka qenë i shtrirë në krevat i cili i bie të jetë ballë për ballë me derën e hyrjes së dhomës e cila mund të jetë në madhësi 4x4 dhe kur i akuzuari N. ka hyr brenda nuk ka folur asgjë vetëm e ka goditur derën dhe ka gjuajtur me armë dhe shtëpia ka pasur dy dhoma poshtë dhe dy dhoma lartë, dy korridore dhe i akuzuari N. nuk ka fjetur ndonjëherë në shtëpinë e tij. Ka theksuar se në momentin deri sa ka qenë përmbi të akuzuarin N. dhe kanë qenë duke u përpjekur që secili nga ata ta marrin armën, i akuzuari N. Ka thirrë o F. për të kërkuar ndihmë e i cili ka ardh menjëherë e ka kapur për beli dhe e ka larguar e në atë momentin N. është ngritur e ka marrë revolen e F. vet, ndërsa i akuzuari F. vetëm e ka larguar nga i akuzuari N. dhe kur ka gjuajtur N. F. ka qenë i tërhequr prapa. Ka shtuar se revolja ka qenë e tyre, predha ka goditur edhe krevatin, kanë qenë edhe fotografitë që dëshmojnë atë dhe i akuzuari N. t kurrë nuk i ka dhënë të holla për fëmijë dhe është e vërtete se i akuzuari N. ja ka marrë 40,00 € e kjo ka ndodhur kur kanë qenë në shtëpinë e F. C..

Eksperti mjeko ligjor **dr. C. M.**, gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 26.01.2017 ka deklaruar se mbetet pranë konstatimeve lidhur me natyrën e lëndimeve trupore të dëmtuarit. Ka shtuar se bëhet fjalë për lëndimin e pësuar në pjesën ballore-murore të kokës e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit e cila në rrugën e vetë ka kaluar lëkurën mbi shtresën e sipërme përkatësisht mbi lëkurën dhe praktika mjeko-ligjore lëndimet e tilla i kualifikon si lëndime të lehta trupore pa rrezikshmëri për jetën. Ka theksuar se në këtë aspekt aktiviteti fizik reduktohet vetëm pjesërisht dhe atë në pjesën e atakuar dhe bënë sqarimin praktik duke theksuar se balli është pjesa e parë mbi vetulla, kurse murorja është pjesa e tepit të kokës pra në këtë pjesë ka qenë e lokalizuar plaga në pjesën ku kufizohet pjesa ballore me pjesën murore. Ka theksuar se bazuar në dokumentacionin mjekësor përpos këtij lëndimi nuk është vërejtur që i dëmtuari ka pasur lëndime tjera trupore dhe pasi lëndimi në kokë nuk i ka atakuar tri shtresat e lëkurës atëherë këto lëndime nuk lejnë gjurmë pas shërimit, por shenjat mbesin vetëm nëse plaga lihet e pashëruara dhe infektohet e në rastin konkret nuk janë këto elemente dhe arsyeja pse i dëmtuara është rekomanduar të konsultohet me neurologun është pasi kur atakohet koka si organ vital është praktikë që të konsultohet neurologu.

Dëshmitari **Z. K.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2012 duke u përgjigjur fillimisht në pyetet e mbrojtjes ka theksuar se të akuzuarin N. P. e njih afërsisht 7-8 vite apo më shumë, me të njëjtin takohen kohë pas kohe, pinë kafe, por nuk kanë ndonjë raport të veçantë, por kohë pas kohe pinë kafe. Ka shtuar se ditën kritike është takuar me N. dhe F. dhe fillimisht në K. është takuar me N. kanë shkuar në Prishtinë ku më vonë janë takuar me të akuzuarin F., e i akuzuari N. i ka thënë a po vjen në fshatin X. pasi kemi me u takuar me të dëmtuarin N. për do para borxh dhe në hyrje të fshatit X. janë ndalur në një lokal kanë ndenjur 4-5 orë e i akuzuari N. ka folur vazhdimisht në telefon sa ka për dijeni me të dëmtuarin N. e dikush përmes telefonit i ka treguar N. se ka ardhur N. e pastaj me automjetin e tij kanë shkuar te dyert e oborrit të shtëpisë së dëmtuarit vet ka qëndruar në automjet në rrugë larg nga dyert e oborrit 20-30 metra e nga automjeti kanë dal N. dhe F. e i akuzuari N. ka qenë i dehur nuk ka qenë shumë nervoz por edhe i akuzuari F. ishte i dehur sepse tërë ditën kanë konsumuar alkool dhe gjatë kohës sa ka qenë duke pritur nuk ka dëgjuar ndonjë krismë si dhe nuk i ka vërejtur N. ndonjë revole. Ka shtuar se është e vërtetë se i akuzuari N. ka kërkuar me dërguar në fshatin X. për shkak të borxhit që ja kishte i dëmtuari N. dhe kur kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit nga automjeti kanë dalur në të njëjtën kohë dy të akuzuarit kurse vet nuk

ka dal nga automjeti dhe afërsisht ata janë vonuar 5-10 minuta dhe gjatë kohës a ka pritur në automjet nuk ka dëgjuar asgjë pasi e ka pasur të lëshuar kasetefonin dhe i kujtohet që të dy të akuzuarit janë kthyer njëkohësisht në automjet. Ka shtuar se pasi janë kthyer në automjet i akuzuari N. i ka treguar se gati më vrau N. e vet është habitur pasi ata janë shok e N. i ka treguar që posa ka hyr brenda N. e ka nxjerr revolen, ndërsa i akuzuari F. nuk ka folur asgjë dhe në automjet kanë qenë vetëm ata të tre dhe nuk ka vërejtur lëndime që kanë pasur qoftë i akuzuari N. apo i akuzuari F..

Dëshmitarja **S. Th.** gjatë dëshmisë së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2012, ka deklaruar se i kujtohet se ishte natë kur kanë shkuar fëmijët e kumatit e i kanë treguar se dy persona kanë hyr në shtëpinë e axhës N. dhe pasi e kanë të ndarë bashkësinë familjare kur kanë dëgjuar ka dalur vet së bashku me kunatën L. dhe vjehrrën Z. dhe kanë shkuar në drejtim të shtëpisë së N. dhe kur kanë hyr brenda në dhomë kanë parë që dy persona ishin mbi kunatin-të dëmtuarin i cili ka qenë i lënduar në kokë dhe kishte gjakderdhje e në këtë moment edhe një herë kanë shkrepur me armë pasi kanë dal nga pragu i derës së korridorit, ka goditur dyshe-menë dhe menjëherë janë larguar. Ka shtuar se pas rastit nuk ka biseduar asgjë me të dëmtuarin rreth rastit, pasi e ka të ndarë shtëpinë dhe shtëpia i kanë larg njëra me tjetrën afërsisht 20 metra dhe sa i kujtohet N. ka qenë i lënduar në anën e majtë të kokës dhe nuk i kujtohet se vjehrra ju ka thënë të akuzuarve prit pak se ti japim paratë. Ka shtuar se N. djalin e madhe ka pasur të sëmur nga temperatura, ka fituar ngërçe dhe kur kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit N. kanë qenë vet, vjehrra dhe kunata L. e cila është gruaja e të dëmtuarit, e po ashtu i kanë gjetur ata dy persona ku njëri prej tyre ka pasur revole.

Dëshmitarja **L. Th.** gjatë dëshmisë së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2012, ka theksuar se natën kritike kanë qenë duke ndenjur në shtëpinë e tyre dhe kunati N. është i ndarë prej tyre, kanë shkuar fëmija dhe ua kanë treguar se po dojnë me vra axhën N. dhe kanë dal menjëherë së bashku me vjehrrën, kunatën por edhe bashkëshorten e N. e cila ishte aty, kanë shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit N.. Ka shtuar se kanë arritur në shtëpinë e N. pas të akuzuarve dhe kur ka arritur në oborr të kunatit-të dëmtuarit njëri prej këtyre personave e shtynte derën me hu me dhunë brenda dhe vjehrra i ka thënë çka po doni. Ka shtuar se e ka vërejtur se një person ishte te dyert e oborrit, tjetri te dera e shtëpisë, e një tjetër te dera e dhomës ku ka qenë i shtrirë N., e ai që ka qenë te dera e dhomës ka shkrepë me revole te këmbët e tyre ku kanë qenë së bashku me vjehrrën dhe dy kunatat. Ka theksuar se të dëmtuarin N. nuk e ka parë sa kanë qenë ata dy persona në shtëpi dhe i treti te dyert e oborrit, por të dëmtuarin e ka parë pasi është kryer ngjarja dhe vetëm i ka dëgjuar kur vjehrrës i kanë thënë se N. kemi punë dhe nuk kemi punë me jua dhe nuk i kujtohet i akuzuari N. si person që ka qenë në oborrin e tyre ndonjëherë. Ka shtuar se i dëmtuari N. e ka pasur djalin e sëmur, por nuk ka dijeni për borxhet dhe kur ka shkrepur revolja nëna e N. dhe gruaja e tij B. kanë qenë te dera e dhomës ku ka qenë N., e vjehrra e shtynte personin që kishte revolen në dorë e ky personi ka shkrepur me revole kanë qenë të gjithë në korridor kur është shkrepur me revole dhe ky personi e shtynte vjehrrën dhe nuk e lejonte për të hyr brenda te djali i vet N. e po ashtu edhe vjehrra e shtynte atë personin për ta nxjerre jashtë, i cili edhe pasi ka dal jashtë i ka mëshuar derës me shqelma dhe krismë tjetër nuk ka dëgjuar përpos kësaj e plumbi ka qenë në largësi prej tyre gjysmë metër deri sa ato mundoheshin që të mos e lejojnë N. me dal nga dhoma.

Nga raporti i repartit të emergjencës për të dëmtuarin N. S. i datës 31.10.2009 është e konstatuar se i njëjti ka qenë për trajtim mjekësor në Spitalin Regjional “Isa Grezda” në Gjakovë pas lëndimeve të pësuar.

Nga mendimi dhe konstatimi i mjekut ligjor dr. C. M. është e konstatuar se lëndimet trupore të dëmtuarit N. S. kualifikohen si lëndime të lehta trupore të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktueshmërisë.

Nga dy gëzhojat e zbrazura dhe një fishek të gjetur në vendin e ngjarjes konstatohet se këto kanë qenë predhat që janë përdorur nga i akuzuari N. me rastin e kryerjes së veprës penale e të cilat janë gjetur në vendin e ngjarjes.

Nga lista e dëshmive të gjetura në vendin e ngjarjes është e konstatuar se në vendin e ngjarjes janë gjetur 2 (dy) gëzhoja, një plumb i pistoletës 7.62 mm, dhe disa njolla të gjakut.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe foto-albumi i vendit të ngjarjes konstatohet se ngjarja ka ndodhur në një shtëpi dy katëshe, ndërsa rasti ka ndodhur në përdhese të shtëpisë në dhomën e ditës, si dhe vërehen gjurmët e veprës si gëzhojat dhe vrimat nga predhat dhe njollat e gjakut.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e prokurorisë të parashtruara si në aktakuzë ashtu edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, pretendimet e mbrojtjes të parashtruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe të gjitha provat e administruara veç e veç, e pastaj të ndërlidhura njëra me tjetrën dhe ka konstatuar se akuzuari N. P., ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 të KPK-së, si dhe i akuzuari F. C. e ka kryer veprën penale tentim vrasje në ndihmë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 dhe nenin 25 të KPK-së. Gjykata deri te ky konstatim ka ardhur pasi ka analizuar të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dëshmia e të dëmtuarit N. S. e dhënë në cilësinë e dëshmitarit, dëshmia e dëshmitarëve Z. K., S. Th., L. Th., dëshmia e ekspertit mjeko-ligjor dr. C. M. lidhur me natyrën e lëndimeve trupore për të dëmtuarin N. S. si dhe nga vet deklarimi i të akuzuarve, e në veçanti nga deklarimi i të akuzuarit F. C. të dhënë gjatë mbrojtjes së tij.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit N. P., avokatit N. D. i cili ka theksuar se mbrojtjes së të akuzuarit N. t duhet ti falet besimi, pasi mbrojtja e të akuzuarit është shumë kredibile, sepse ka mbështetje në shumë prova të administruara dhe ka konstatuar se pretendimi i tillë i mbrojtjes është i pa bazuar për faktin se gjykata ka konstatuar se mbrojtja e të akuzuarit N. P. është kontradiktore dhe nuk përputhet me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu nuk përputhet edhe me deklaratën e të akuzuarit F. C. për mënyrën se si është kryer vepra penale, andaj si të tillë gjykata mbrojtjes së të akuzuarit nuk ja ka falur besimin. Pretendimi i mbrojtjes se nuk ka ekzistuar motivi apo dashja për privimin nga jeta të dëmtuarin, sepse me asnjërën nga provat e administruara nuk është vërtetuar dashja e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, pasi sasia e të hollave që i dëmtuari ja ka pasur borxh të akuzuarit nuk ka mund që ta motivoi të akuzuarin për ta kryer vrasjes apo tentim vrasjes dhe gjykata ka konstatuar se ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar, pasi nga vet deklarimi i të akuzuarit N. i cili gjatë mbrojtjes së tij ka theksuar se të hollat kanë qenë arsyeja pse ka ardhur deri te konflikti gjykata e ka vërtetuar motivin e të akuzuarit për kryerjen e kësaj vepre penale, e po ashtu motivin për kryerjen e kësaj vepre penale gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklarata e të akuzuarit F. C. të parashtruar gjatë mbrojtjes së tij i cili ka theksuar se kur ka hyr brenda në shtëpinë e të dëmtuarit deri sa i dëmtuari e kishte kapur për fyti të akuzuarin N. i dëmtuari e ka pyetur çka ka o bir N., e vet i është përgjigjur qysh çka ka pasi nuk ja ke larë paratë. Ndërsa dashjen e të akuzuarit për kryerjen e kësaj vepre penale gjykata e ka vërtetuar nga dëshmia e të

dëmtuarit N. S. e cila dëshmi përputhet me deklaratimet e të akuzuarit F. C. lidhur me mënyrën se si janë kryer veprat penale, pasi edhe vet i akuzuari F. ka theksuar se i akuzuari N. ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit dhe e ka goditur në kokë në momentin kur vet i akuzuari F. e ka larguar të dëmtuarin e pastaj i akuzuari N. e ka marrë armën dhe ka shtënë në drejtim të dëmtuarit duke goditur në kokë, e duke pasur parasysh faktin se ka gjuajtur në kokë si organ vital dhe afërsia që ka pasur i akuzuari me të dëmtuarin pasi ngjarja është zhvilluar brenda në dhomë, atëherë gjykata ka konstatuar dashjen e të akuzuarit N. për ta kryer këtë vepër penale.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e mbrojtjes se i akuzuari N. të gjitha veprimet i ka ndërmarrë në një situatë të mbrojtjes nga i dëmtuari dhe ka konstatuar se pretendimi i tillë i mbrojtjes është i pabazuar për faktin se fillimisht i dëmtuari ka qenë në shtëpinë e tij kur është sulmuar nga i akuzuari dhe në momentin kur i dëmtuari është goditur me armë nuk ka qenë duke sulmuar të akuzuarin N., por pasi i akuzuari F. e ka kapur për beli dhe e ka larguar të dëmtuarin N. nga i akuzuari N., i njëjti e ka marrë revolen e cila paraprakisht kishte rënë në tokë, e me të ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit, duke goditur në pjesën e kokës, andaj sipas vlerësimit të gjykatës në këtë rast nuk ka pasur kurrfarë mbrojtje ashtu siç pretendohet pasi nuk ka ekzistuar sulmi nga i dëmtuari, e këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara si dëshmia e të dëmtuarit e cila dëshmi përputhet edhe me deklaratimet të akuzuarit F.C. për mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe me konstatimet e ekspertit mjeko-ligjor dr. C. M., i cili ka theksuar se lëndimi trupor të dëmtuarit i është shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së armës së zjarrit.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të akuzuarit N. P. të parashtruara gjatë mbrojtjes së tij i cili ka theksuar se fillimisht ka qenë i sulmuar nga i dëmtuari dhe kur ja ka marrë revolen të dëmtuarit dhe ka qenë duke e goditur në kokë me revole ka kërcitur revolja dhe sipas të akuzuarit ky është momenti kur është plagosur i dëmtuari, e pastaj pasi ka hyr i akuzuari Fadil deri sa vet ka qenë duke u kacafytur me të dëmtuarin N., i dëmtuari vet e ka lëshuar, e atëherë vet personalisht e ka marrë armën e cila ishte në tokë dhe ka gjuajtur edhe një herë aftësisht një metër afër krevatit në tokë dhe gjykata ka konstatuar se pretendimet e tilla të akuzuarit janë të pabazuar dhe të pa argumentuara me asnjë provë apo dëshmi të vetme, kontradiktore me vet deklaratimet e mëparshme të akuzuarit, si dhe me provat tjera, pasi i dëmtuari N. ka theksuar se momenti kur është goditur me armë nga i akuzuari N. ka qenë kur në dhomë ka hyr i akuzuari F. C. dhe e ka larguar të dëmtuarin, e më atë rast i akuzuari N. e ka marrë revolen nga toka e ka shkrepur në drejtim të dëmtuarit, e këtë fakt e ka pohuar edhe vet i akuzuari F. C. gjatë mbrojtjes së tij i cili ka theksuar se kur ka hyr brenda në dhomë e ka parë që i dëmtuari e kishte kapur të akuzuarin për fyti, vet e ka kapur të dëmtuarin për beli dhe e ka larguar nga N., e revolja kishte pas rënë në dysheme të dhomës, e atëherë i akuzuari N. e ka kapur revolen dhe ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit N. i cili fishek e ka goditur përshkitazi në kokë, pra dëshmia e të dëmtuarit përputhet në tërësi me deklaratimet e të akuzuarit F. C. lidhur me momentin kur është plagosur i dëmtuari nga i akuzuari N.

Gjykata mbrojtjes së të akuzuarit N. P. nuk ja ka falur besimin edhe për faktin se i akuzuari N. ka theksuar se nuk e ka thirrur F. për të hyr brenda, ndërsa i dëmtuari

N. gjatë dëshmisë së tij ka theksuar se i akuzuari N. e ka thirrur F. derisa kanë qenë duke u kacafytur me të, e po ashtu edhe i akuzuari F. ka theksuar se i akuzuari N. e ka thirrur F. e pastaj vet ka hyr brenda dhe e ka kapur të dëmtuarin dhe e ka larguar nga i akuzuari N.. Mbrojtjes së të akuzuarit N. gjykata nuk ja ka falur besimin edhe për faktin se i akuzuari N. ka theksuar se i dëmtuari N. ka qenë i lënduar para se i akuzuari F. të hyj brenda, ndërsa i akuzuari F. ka

dëshmuar të kundërtën i cili ka theksuar se i dëmtuari nuk ka pasur gjak pra nuk ka qenë i lënduar, e po ashtu edhe i dëmtuari N. S. ka dëshmuar se është lënduar pasi i akuzuari F. ka hyr në dhomë, e po ashtu gjykata nuk ja ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit N. i cili ka theksuar se revolen e ka gjuajtur në oborr te lulet ndërsa karikatorin e ka marrur me veti dhe gjatë rrugës e ka hapur dritaren dhe e ka humbur, pasi i akuzuari F. ka theksuar se nuk e ka parë këtë fakt sepse do ta kishte parë pasi ka qenë i ulur prapa dhe nuk ka parë që i akuzuari N. e ka hapur xhamin e automjetit dhe e ka gjuajtur karikatorin, e bazuar në të gjitha këto kontradikta të deklarimeve të akuzuarit N. P. gjykata nuk ja ka falur besimin edhe pretendimit të tij se revolja ka qenë e të dëmtuarit, por lidhur me këtë fakt gjykata besimin ja ka falur dëshmisë së të dëmtuarit N. S. i cili ka theksuar se revolja ka qenë e të akuzuarit N. P., pasi gjykata ka konstatuar se dëshmia e të dëmtuarit për mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe mënyrës se si të akuzuarit kanë shkuar në shtëpinë e tij përputhet dhe është në harmoni të plotë edhe me dëshmitë e dëshmitarëve Z. K., S. Th., L. Th., ekspertit mjeko-ligjor dr. C. M. si dhe me deklaratimet e të akuzuarit F. C..

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit F. C. avokatit P. P. i cili ka theksuar se në veprimet e të akuzuarit F. C. nuk janë përmbushur elementet e veprës penale ndihmë të vrasjes në tentativë, pasi prokuroria ka dështuar të vërtetojë se i akuzuari F. duke larguar pengesat me dashje e ka ndihmuar tjetrin që ta kryen veprën penale si në aktakuzë dhe gjykata ka konstatuar se ky pretendim është i pabazuar për faktin se vet i akuzuari F. C. ka dëshmuar se ditën kritike nga Prishtina ka shkuar në fshatin X. në shtëpinë e të dëmtuarit dhe e ka ditur arsyen e shkuarjes te shtëpia e të dëmtuarit pasi i akuzuari F. ka theksuar se kur ka hyr brenda në dhomë i dëmtuari N. e ka pyetur “çka ka o bir N.“ e vetë i është përgjigjur qysh çka ka nuk ja ke larë paratë, pra i akuzuari F. ka pasur për dijeni motivin dhe arsyen se pse kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit dhe gjykata ka konstatuar se veprimet e ndihmës të akuzuarit F. ekzistojnë në momentin se kur i akuzuari N. dhe i dëmtuari N. kanë qenë duke u kacafytur, e revolja ka qenë në dysheme i akuzuari F. nuk i ka ndarë por i ka ndihmuar te akuzuarin N. duke e kapur për beli të dëmtuarin N. duke e larguar nga i akuzuari e pastaj ja ka krijuar mundësinë të akuzuarit N. që ta merr revolen nga dyshemeja dhe të gjuan në drejtim të dëmtuarit N., e i akuzuari F. vet është larguar në momentin kur ka gjuajtur, pra sipas vlerësimit të gjykatës këtu ekziston ndihma që i akuzuari Fadil ja ka dhënë të akuzuarit N., pasi i akuzuari F. në dhomë ka hyr pasi e ka thirr i akuzuari N. për ti ndihmuar o F., po ashtu gjykata ka konstatuar se i akuzuari F. e ka ndihmuar të akuzuarin N. edhe për tu larguar pasi vet i akuzuari F. ka theksuar se pasi i akuzuari N. ka gjuajtur e ka marrë të njëjtin dhe janë larguar nga shtëpia pasi kanë ardhur gruaja dhe fëmijët e ku N. edhe njëherë ka gjuajtur me revole në tokë.

Gjykata faktin se të akuzuarit N. dhe F. kanë qenë së bashku dhe kanë pasur njohuri për arsyet e shkuarjes në shtëpinë e të dëmtuarit e ka vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit Z. K. i cili ka theksuar se kur kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit vet ka qëndruar në automjet ndërsa në të njëjtën kohë nga automjeti kanë dalë i akuzuari N. dhe F. dhe janë vonuar afërsisht 5-10 minuta dhe po ashtu njëkohësisht të dy të akuzuarit janë kthyer në automjet.

Gjykata nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore një nga një, e pastaj të ndërlidhura njëra me tjetrën ka konstatuar se i akuzuari N. P. me dashje ka tentuar që ta privoj nga jeta të dëmtuarin N. S. me çka ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 par. 1 të KPK-së, si dhe i akuzuari F. C. me dashje e ka ndihmuar të akuzuarin N. P. për kryerjen e veprës penale me çka ka kryer veprën penale të tentim vrasjes në ndihmë nga neni 146 lidhur me 20 par. 1 dhe nenin 25 të KPK-së, të përshkruara si në dispozitivat e aktgjykimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe për të dy të akuzuarit ka vërtetuar edhe nga vetë deklarimi i tyre se edhe më parë kanë qenë të dënuar për vepra të ndryshme penale, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, ka marrë parasysh sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, kohën e kaluar nga kryerja e kësaj vepre penale, faktin se më nuk janë të evidentuar si kryes të ndonjë vepre tjetër penale, e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit nga neni 67 par. 1 nën par. 2 të KPK-së për dy të akuzuarit dhe të akuzuarit N. të ja shqipton dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor atë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, ndërsa të akuzuarit F.C. i ka shqiptuar po ashtu dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.06.2012 deri me datë 29.06.2012, me bindjen e plotë se këto dënime janë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetin e të akuzuarve dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPK-së.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 112 par. 2 të KPPK-së, pasi i dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare vetëm ka kërkuar kompensim dëmi por pa e përcaktuar lartësinë e kompensimit të kërkuar.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 99 par. 1 dhe 2 nën par. 1 dhe 6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
PKR. nr. 59/15 datë 23.02.2017

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i Trupit Gjyqësor-gjyqtari
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.